



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 02 .

Prishtinë, më 29.12.2014, në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Milosavljević, Agim Ceku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Milka Vuletić, Slavko Simić, Jasmina Živković, Ćerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Mungon: Blerim Shala

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinate - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Milosavljević, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi – i njoftoi anëtarët se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtua dhe miratuar raportin me amendamente të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2015, i njëjti është plotësuar me tri amendamente të reja: 61,63 dhe 64.

Për arsye të respektimit të afateve kohore, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim sot do të shqyrtoj Projektligjin me amendamentet shtesë dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandime të cilat do t'i dërgohen Komisionit Funkcional.

Myfera Sinik- në kuadër të propozimit të GP 6 + në përbërje të komunitetit turk, boshnjak, romë dhe ashkali ka pregaditur amandament dhe është proceduar në komisionin funksional për Buxhet dhe Financa. Dha sqarim se amandamenti ka për qëllim që shpenzime buxhetore të kenë kod të veçantë për komunitetin joshqiptar dhe joserb. Për implementimin e këtij projekti, përgjegjësia bie në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

Kërkesa e saj ishte që amandamentin e GP 6 + të marr përkrahjen e plotë të Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Jasmina Zivkovic –lidhur me propozim amandamentin e GP 6+, kërkoi sqarim se për formimin e kodit të veçantë, përgjegjësia bie në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim apo e njëjta i obligon edhe linjat tjera ministrore.

Veton Berisha, shprehu qëndrimin e tij se komisioni funksional ka bërë një punë të mrekullueshme, me rastin e formulimit të amendamentit 35, me tekstin që të fshihet termi ‘maxhupit’. Gjithashtu kërkoi që në të ardhmen ky termë të mos përdoret në dokumentet zyrtar.

Ndarja buxhetore nuk specifikohet me numrin e përfaqësimit të komuniteteve nga se në bazë të strukturave nacionale, nuk janë të barabartë.

Si kërkesë e tij kryesore është që komuniteti egjiptian të jete i përfshir në çdo kod buxhetor. Ai konsideron se Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet të jetë më përgjegjëse në trajtimin e komuniteteve për të arritur inkudrimin e tyre në shoqërinë Kosovare.

Dekarohet se vota e tij është pro miratimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2015.

Danush Ademi – pajtohet me diskutimin e znj. Mufera, se GP 6 +, se kemi adresuar shkresën në Komisionin për Buxhet dhe Financa, me arsye që MKK të ndajë mjete buxhetor në vlerë prej 900 mijë euro, për raste sociale. Planifikimi i projektit ka qenë të ndërtohen 90 shtëpi; 25 shtëpi në KK Ferizaj, 20 shtëpi në Lipjan, 25 shtëpi në Gjakovë dhe disa shtëpi në Fushë Kosovë.

Kërkesa e tij ishte, të bëhet specifikimi i kodit të veçantë për komunitetin ashkali, si nga Ministria për Komunitete dhe Kthim ashtu edhe nga linja përkatëse ministrore..

Ai ceku se në bazë të ligjit është përcaktuar 10 % e buxhetit të takon komunitetit jo shumicë, ndërsa kjo çështje në praktikë nuk funksionon me vite të tëra.

Cerim Bajrami – sqaroi se amendamenti i propozuar nga GP 6+ ka për qëllim të formohet një kod i veçantë për komunitetin jo-shumicë. Për sigurimin e mjeteve buxhetore përgjegjësia bie në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Ai u shpreh se në të ardhmen kjo ministri duhet të jetë më konstruktive në ndarjen e mjeteve buxhetore.

Ai tha se do të votojë Buxhetin e Kosovës për vitin 2015, me arsye të perspektivës së qytetarëve të Kosovës.

Mirëpo si kërkesë e tij ishte që Komisioni të ketë mirëkuptim në miratimin e amendamentit të GP 6+. Ai dha shpjegim se kjo çështje nuk do të jetë në dëm të komuniteteve tjera

Agim Kikaj – shprehu qëndrimin e tij se mbështet rekomandimin e komisionit funksional për buxhet dhe financa në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2015.

Njëherit përkrah edhe propozimin e GP 6 +. Fillimisht kërkoi që të konsultohet korniza ligjore.

Sa i përket linjës së veçantë buxhetore, duhet pasur parasysh se programi i projekteve zhvillimore rregullohet me ligjin për shërbyesit civil. Për këtë çështje mund të rishikohet organogrami i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Kryesuesi – ai shprehu mendimin e tij se të drejtat e të gjitha komuniteteve janë të garantuara me Kushtetutë dhe me Ligje.

Ka informatë, se MKK ka përfunduar plan- programin për vitin 2015. Gjegjësisht, kërkesat e pakënaqura të komuniteteve mund të drejtohen në ministrinë për Komunitete dhe Kthim, kur planifikohet programi për vitin e ardhshëm.

Pas diskutimeve lidhur me amendamentin e GP +, Kryetari konstatoi se Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me 3 vota për, 5 vota kundër dhe 2 abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Në kuadër të pamundësisë që Qeveria e Kosovës të ndaj buxhet të veçantë për komunitetin jo shumicë, refuzohet propozim - amendamenti i GP 6 +.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amandamente të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe amendamentet shtesë: 61,63 dhe 64, dhe të njëjtat i miratoi.:

Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me 7 vota për, 4 kundër, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Saša Milosavljević